



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni Pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-012
Prishtinë, më 16 shkurt 2015, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 16 SHKURT 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Emrush Haxhiu, Sali Rexhepi, Fehmi Hyseni, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia e Kuvendit

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 9 shkurt 2015,
2. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave dhe
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 9 shkurt 2015

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 9 shkurt 2015.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe kërkesave

1. Rekomandimi i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me shkresën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Kryesia, pasi u njoftua lidhur me rekomandimin e lartshënuar, nxori këtë:

Përfundim

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që sa më shpejt t'ia procedojë Kuvendit propozimin për plotësimin e Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

2. Propozimi i Komisionit për Punë të Jashtme për formimin e grupeve të miqësisë dhe riformimin në fillim të mandatit të ri parlamentar

Lidhur me propozimin për formimin e grupeve të miqësisë dhe riformimin në fillim të mandatit të ri parlamentar diskutuan: Xhavit Haliti dhe Sabri Hamiti, nënkryetarë të Kuvendit, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin për formimin e grupeve të miqësisë:

V E N D O S I

1. Formohen grupet e miqësisë ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe parlamenteve të shteteve tjera, sipas propozimit të Kryesisë së Kuvendit.

2. Kërkohej nga deputetët e Kuvendit që mbi bazën e propozimit të Kryesisë së Kuvendit, të deklarohen se në cilin grup të miqësisë dëshirojnë të jenë anëtarë.

3. Autorizohet nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti që, pas deklarimeve të deputetëve, ta përgatisë propozimin përfundimtar për formimin e grupeve të miqësisë, të specifikuar me parlamentet e shteteve përkatëse dhe t’ia paraqesë Kryesisë së Kuvendit në mbledhjen tjetër të radhës.

3. Kërkesa e Komisionit për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e kryesuesit të Komisionit Shqyrtues të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Të shpallet konkursi për zgjedhjen e kryesuesit të Komisionit Shqyrtues të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim.

2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që në bazë të dispozitave të Ligjit nr. 03/L-086, si dhe vendimit të Komisionit për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, ta shpallë konkursin për zgjedhjen e kryesuesit të Komisionit Shqyrtues të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim, sipas tekstit të bashkangjitur.

4. Njoftimi i Grupit Parlamentar “Nisma” për emërimin e deputetes Valdete Bajrami kryetare të këtij Grupi Parlamentar

Kryesia u njoftua me vendimin e Grupit Parlamentar “Nisma” për emërimin e deputetes Valdete Bajrami kryetare të këtij grupi parlamentar.

Pikat shitesë

1. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të dala nga organizimi i festimit të 7-vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

Vendim

2. Me rastin e shënimit të 7-vjetorit të pavarësisë së Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës do të mbajë seancë solemne më 17 shkurt 2015, në orën 15:00.

2. Të gjitha shpenzimet e aktiviteteve që organizohen nga Kuvendi me rastin e shënimit të 7-vjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës mbulohen nga buxheti i Kuvendit.

2. Kërkesa për aprovimin e shpenzimeve për pritjen e delegacionit të udhëhequr nga kryetari i Parlamentit të Suedisë Sh. T. Z. Urban Ahlin nga data 22-23 shkurt 2015

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

Vendim

Miratohet kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të akomodimit, drekës zyrtare, si dhe shpenzimet tjera të dala shtesë me rastin e pritjes së delegacionit nga Parlamenti i Suedisë, që do ta vizitojë Kosovën prej datës 22-23 shkurt 2015, sipas kërkesës nr. 05/344/DO-250, dt. 16.02.2015.

Të ndryshme

1. Rishqyrtimi i vendimit për përfitimet e ish-kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Jakup Krasniqi, datë 21 janar 2015

Kryetari i njoftoi nënkryetarët e Kuvendit se në bazë të Ligjit për përfitimin e ish-zyrtarëve të lartë, Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 21 janar 2015, ka vendosur për përfitimet e ish-kryetarit të Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

Ai theksoi se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 9 shkurt 2015, ka kërkuar një interpretim ligjor nga Drejtoria e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale e Administratës së Kuvendit që të rishikohet nëse vendimi është në pajtim me Ligjin për përfitimin e ish-zyrtarëve të lartë.

Kryetari konstatoi se Drejtoria e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale e ka analizuar vendimin e marrë nga Kryesia e Kuvendit dhe ka vlerësuar se i njëjti është në pajtim me Ligjin për përfitimin e ish-zyrtarëve të lartë.

Lidhur me rishqyrtimin e vendimit për përfitimet e ish-kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Jakup Krasniqi, diskutoi Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit, diskutimi i të cilit është dhënë në transkript.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë në orën 11:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtoria për çështje plenare dhe procedurale*